



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

Sheshi: « Nënë Tereza », Nr.4, Tirane

Tel: +355 4 2227914

www.upt.al

Nr 1121/ Prot

2

Tiranë, më 14.10. 2015

**MIRATOHET
REKTORI**

Akademik JORGAQ KAÇANI

**Plani Strategjik dhe Vjetor i veprimtarisë së auditimit të brendshëm të Universitetit
Politeknik Tiranë për periudhën 2016 - 2020**

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) është institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. UPT ka në përbërjen e tij 7 fakultete dhe një institut kërkimi e zhvillimi.

Misioni i UPT është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë e të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencetarë të rinj; të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor dhe të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar e rajonal.

UPT ka këtë strukturë bazë:

- Administrata e Rektoratit
- Fakultetet
- Institutet e Kërkimit dhe Zhvillimit
- Njësi ndihmëse

Struktura e Auditit të Brendshëm (AB) është pjesë e strukturës së Administratës së Rektoratit dhe është ngritur në nivel sektori. Përbërja e këtij sektori është miratuar me një përgjegjës dhe një specialist audit; por, aktualisht sektori funksionon vetëm me përgjegjës e tij.

I. Plani Strategjik për periudhën 2016-2020

Qëllimi i planit strategjik.

Plani strategjik ka për qëllim të përcaktojë punën që do të ndërmerret nga struktura e auditit të brendshëm të UPT për periudhën e ardhshme 5-vjeçare 2016-2020.

Në këtë plan strategjik do të programohen veprimtaritë kryesore të planifikuara për tu kryer në periudhën 2016-2020, për tu siguruar që sistemet/fushat e identifikuara me risk mbulohen me auditim gjatë kësaj periudhe. Frekuenca e auditimit duhet të sigurojë përfshirje të

mjaftueshme sipas kohës së përcaktuar në auditimin e subjekteve, për të dhënë një vlerësim të përgjithshëm të funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Objektivat e auditimit të brendshëm.

- Programimi dhe kryerja e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke ruajtur frekuencën e auditimit, vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit.
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e tij.
- Ndjekja në vazhdimësi të rekomandimeve të dhëna nga auditimet, në bazë të planit të miratuar për ndjekjen e tyre.
- Minimizimi i kostos së auditimit duke u përqendruar në sistemet apo fushat me risk të lartë e të mesëm.

Mjedisi i punës dhe Kuadri Ligjor.

Sektori i Auditit të Brendshëm në UPT ushtron dhe do të ushtrojë veprimtarinë e tij duke zbatuar Ligjin Nr.9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar; Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhërin Nr. 69, datë. 29.09.2010 si dhe Udhëzimin Nr.12, datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Qëllimi dhe misioni i AB.

Sipas përcaktimit të bërë në Ligjin për AB, auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për drejtimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e njësisë publike. Ai e ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat e veta, me anën e një mënyre të disiplinuar dhe sistematike për të vlerësuar e për të përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes publike. Në interpretim të përkufizimit të AB dhe përcaktimeve të tjera të bëra në ligj, auditimi i brendshëm në rektorat synon:

Të mbështesë UPT për të arritur qëllimet e saj duke ndihmuar Rektorin të identifikojë dhe vlerësojë risqet e universitetit; duke vlerësuar sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarive të UPT.

Prioritete dhe fokusimi i veprimtarisë audituese për vitet 2016-2020.

Veprimtaria audituese e sektorit të AB në UPT për vitet 2016-2020, do të përqendrohet në auditimet e plota, sipas programimit, një herë në vit në Rektoratin e UPT dhe një herë në dy vjet në fakultete dhe institut. Gjatë përgatitjes së këtij plani, janë identifikuar sistemet kryesore, në të cilat do të fokusohet veprimtaria audituese:

Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore;

Sistemet e proceseve organizative: Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit;

Sistemi i pagesave, në të cilin përfshihen edhe pagesat për projekte të ndryshme, si dhe pagesat për fondet IPA;

Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar;

Sistemi i prokurimeve/investimeve.

Përveç auditimeve të plota, janë programuar edhe auditime të ndjekjes së rekomandimeve të lëna në auditimet paraardhëse.

Prioritetet e sektorit të auditimit, në zbatim të kërkesave të ligjit për auditimin dhe rekomandimeve të dhëna, do të jenë:

a. Identifikimi i sistemeve dhe i fushave të llogarisë.

Pavarësisht se struktura e AB në UPT në nivel sektori është miratuar në vitin 2014 dhe nuk funksionon e plotë, pasi është plotësuar vetëm pozicioni i përgjegjës së sektorit; nga auditimet e kryera në dy prej fakulteteve, AB ka mundur të njohë mirë organizatën, mjedisin në të cilin ajo vepron dhe risqet kryesore që i kanoson. Kryerja e dy auditimeve në fakultete dhe njohja me raportin final të auditimit të strukturës së AB të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, bën të mundur identifikimin e një pjesë të mirë të risqeve kryesore, duke siguruar hartimin e një plani auditimi vjetor dhe strategjik gjithëpërfshirës, eficient dhe produktiv.

Duke iu referuar mënyrës së strukturimit dhe organizimit të UPT, në formatin standard nr.4 janë identifikuar sistemet dhe fushat kryesore të llogarive.

b. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve.

Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve është bazuar më së shumti në gjykimin profesional të audituesit të brendshëm.

Sipas përkufizimit të riskut, vlerësimi i riskut është bërë mbi bazën e analizës së faktorëve të cilët kanë mundësinë më të madhe për të shkaktuar një ngjarje të papritur që mund të ketë ndikim në arritjen e objektivave të organizatës dhe natyrisht duke i dhënë prioritet gjithashtu dhe fushave të cilat kanë mundësinë më të lartë për të patur një ndikim negativ nga ndodhja e kësaj ngjarjeje. Sipas format standard nr.5 është bërë analiza e sistemeve dhe fushave të llogarive për nga rëndësia, materialiteti, ndryshimi, risku, pikëpamjet e menaxhimit dhe presionet nga jashtë. Pas analizës së të gjithë komponentëve, është përcaktuar reagimi i auditimit të brendshëm, pra frekuenca me mbulim e sistemeve të identifikuar; Format Standard nr.5.

c. Programimi i veprimtarive, frekuencat e auditimeve dhe parashikimi i tyre sipas llojit dhe periudhës së kryerjes.

Pas identifikimit dhe analizës së sistemeve dhe fushave të llogarive, është përcaktuar frekuenca dhe afatet kohore për misionet e auditimit.

Në planin strategjik është përfshirë auditimi i fakulteteve dhe institutit me frekuencë një herë në dy vjet dhe auditimi i administratës së rektoratit me frekuencë mbulimi çdo vit.

Gjithashtu, në planin strategjik është parashikuar edhe kryerja e auditimit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve në fakultete dhe institut, pasi rektorati është parashikuar për auditim çdo vit.

Duke iu referuar këtij programimi dhe burimeve njerëzore në dispozicion, është parashikuar se në një vit kalendarik do të kryhen 8-10 auditime, prej të cilave 5-6 janë auditime të plota dhe 3-4 auditime janë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Burimet e auditimit

Sektori i Auditimit të Brendshëm në UPT përbëhet nga dy punonjës, sipas strukture 1+1, pra një përgjegjës dhe një specialist. Sikurse është përmendur në paragrafin e parë të këtij dokumenti, aktualisht sektori funksionon vetëm me përgjegjësin e tij.

Sipas analizës së përlllogaritjes së burimeve njerëzore (pasqyra nr.3); identifikimit të riskut për çdo sistem si dhe kompleksitetit të fushave të llogarive, është përcaktuar koha standarde për kryerjen e çdo misioni auditimi.

Plani strategjik dhe vjetor mund të rishikohen, nëse sektori i auditimit të brendshëm do të plotësohet me burime njerëzore, sipas strukturës së miratuar dhe sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin e këshillit të ministrave.

Kufizimet e auditimit. Një prej kufizimeve të auditimit është vetë funksionimi i strukturës së AB. Me përbërjen aktuale, pra vetëm të përgjegjës të sektorit, por edhe nëse plotësohet vendi vakand i specialistit, nuk arrihet të kryhet rishikimi i brendshëm i cilësisë së auditimit dhe nuk përmbushen kërkesat e funksionimit të AB, përcaktuar në VKM nr.212, datë

30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 2.

Një tjetër kufizim është mbivendosja e auditimeve; mbivendosje e cila mund të çojë në moskryerjen e misionëve të plota të auditimit çdo vit të rektoratit të UPT, nga struktura e AB në UPT.

UPT u auditua gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, sipas një misioni të plotë auditimi nga struktura e AB në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.

Me miratimin e ligjit të ri të auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe në bashkëpunim me strukturën e AB në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, pritet të zgjidhet ky problem.

Përveç sa më sipër, Sektori i AB në UPT, gjatë realizimit të programimit të bërë, mund të përballë me risqet e vetë auditimit, të cilat mund të jenë të brendshme dhe ose të jashtme, të cilat mund të jenë:

Rreziku i moszbulimit, i cili është rreziku që audituesi me përdorimin e procedurave thelbësore, nuk arrin të zbulojë një anomalë.

Rreziku i mospërcaktimit të saktë dhe marrjes në konsideratë të nivelit të materialitetit.

Kostoja e auditimit.

Kosto paraprake e auditimit, e llogaritur përafërsisht, është bazuar në elementet e saj si paga bruto, e paazhornuar me marzhin e rritjes së saj sipas normës së inflacionit; si dhe shpenzime të tjera si kancelari e shtypshkrime, energji e ujë.

Në koston e auditimit nuk është parashikuar asnjë shpenzim për trajnim, meqenëse këto shpenzime parashikohen nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF dhe meqenëse deri tani nuk kemi paracaktuar asnjë pjesëmarrje në trajnim.

II. Plan i Vjetor i auditimit 2016

Objektivat vjetore të sektorit të AB.

Sikurse është përmendur më sipër, objektivat kryesore vjetore të sektorit të AB në UPT janë:

- Programimi dhe kryerja e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke ruajtur frekuencën e auditimit, vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit.
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e tij.
- Ndjekja në vazhdimësi të rekomandimeve të dhëna nga auditimet, në bazë të planit të miratuar për ndjekjen e tyre.
- Minimizimi i koston të auditimit duke u përqendruar në sistemet apo fushat me risk të lartë e të mesëm.

Programimi i veprimtarive, frekuencat e auditimeve dhe parashikimi i tyre sipas llojit dhe periudhës së kryerjes si dhe kontrolli dhe sigurimi i cilësisë.

Në planin vjetor të vitit 2016 janë përcaktuar 5 auditime të plota, 4 prej të cilave janë fakultete dhe një është Rektorati. Gjithashtu, gjatë këtij viti janë përcaktuar 3 auditime për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, të lëna nga auditimet e kryera gjatë vitit 2015.

Gjashtëmujorin e parë janë planifikuar për auditim të plotë vetëm dy fakultete, pasi: Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit është një prej fakulteteve me numrin më të madh të studenteve dhe ka mbi dy vjet që nuk është audituar nga struktura e AB në Rektorat; ndërsa Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës është krijuar në vitin 2013, duke u veçuar nga Fakulteti i Ndërtimit. Që nga momenti i krijimit, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës nuk është audituar nga struktura e AB në UPT.

Gjashtëmujorin e dytë janë përcaktuar për auditim të plotë 2 fakultete të tjera dhe Rektorati i UPT, si dhe 1 auditim për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Gjatë përgatitjes së planit strategjik dhe vjetor janë identifikuar sistemet dhe fushat e llogarive, të cilat do të përfshihen në misionet e auditimit, pa përjashtuar auditimin e fondeve IPA, nëse do të ketë. Këto misione auditimi do të kryhen duke u bazuar në vlerësimin e riskut për çdo sistem e më pas në vlerësimin e përgjithshëm të riskut, si dhe vlerësimin e nivelit të materialitetit.

Rreziket e mundshme në kushtet e realizimit të programit vjetor.

Përcaktimi për auditim të plotë i njësisve vartëse është bërë duke u bazuar në frekuencën e auditimit. Gjatë kryerjes së angazhimeve të auditimit, do të mbulohet gjithë veprimtaria e njësisve të përcaktuara për auditim.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të arsimit të lartë, si dhe organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese akademike, bordin e administrimit, etj, mund të kërkojnë auditime të pjesshme nga Titullari i UPT, në mbështetje të prioritetëve dhe objektivave të vendosura nga menaxhimi i ri. Për këtë arsye, nëse kjo mund të ndodhë, atëherë plani vjetor do të rishikohet për t'u përshtatur ndaj kërkesave të menaxhimit të lartë.

Burimet e auditimit dhe alokimi i tyre.

Plani vjetor, ashtu si plani strategjik për periudhën 2016-2020, është përgatitur mbi bazën e burimeve njerëzore aktuale në dispozicion, pra vetëm të përgjegjës të sektorit.

Koha në dispozicion për një auditim të plotë është përlllogaritur 7-8 javë, meqenëse auditimi kryhet vetëm nga një audituese e brendshme, e cila është njëkohësisht edhe përgjegjëse e sektorit të auditimit.

Në rast ristrukturimi, si të strukturës organizative, ashtu edhe të veprimtarisë e sistemeve kryesore (në rast decentralizimi pagesash e prokurimesh), plani vjetor i strukturës së AB do të rishikohet për tu përshtatur me kërkesat e reja të organizatës.

Kufizimet e mundshme të qëllimit të auditit.

Sikurse është përmendur më sipër, ndryshimi i kuadrit ligjor të arsimit të lartë dhe zgjedhja e organizimi i zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese akademike, bordin e administrimit, etj, mund të çojnë në mosrealizimin e këtij plani vjetor. Por, përveç kësaj, disa prej kufizimeve të mundshme të qëllimit të auditit, mund të jenë:

- Zgjatja e afateve kohore përtej afatit të parashikuar e të përcaktuar në programin e auditimit.
- Administrimi i dosjes koherente dhe dosjes së përhershme të AB, sipas kërkesave dhe standardeve të AB, të pranuar.
- Rishikimi i brendshëm i cilësisë së auditimit.

Kostoja e auditimit.

Kostoja e auditimit është përlllogaritur sipas zërave të përcaktuar në pasqyrën Nr.4, në të cilën është përfshirë paga bruto si dhe shpenzime të tjera si kancelari e shtypshkrime, energji e ujë.

Në koston e auditimit nuk është parashikuar asnjë shpenzim për trajnim, meqenëse këto shpenzime parashikohen nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF dhe meqenëse deri tani nuk kemi paracaktuar asnjë pjesëmarrje në trajnim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Silvana Gushali, Përgjegjëse e Sektorit të Auditimit të Brendshëm

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TIRANË

Pasqyra Nr.1

PLANI STRATEGJIK I OBJEKTEVE PËR TU AUDITUAR NGA NJAB nga VITI 2016 deri në VITIN 2020

Nr	Objekte për t'u audituar nga NJAB	Fusha për t'u audituar	Niveli i vlerësimit të riskut i ulët/i mesëm/i lartë	Planifikuar për Auditim (1+4)					
				Realizimi i pritshëm 2015	Viti i ardhshëm 2016	Viti I planif+1 2017	Viti II planif+2 2018	Viti III planif+3 2019	Viti IV planif+4 2020
a.	1	2	3	4.1	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5
1	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit		i mesëm	1	1	1	1	1	1
2	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike		i mesëm	1	1	1	1	1	1
3	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike		i mesëm	1	1	1	1	1	1
4	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit		i mesëm	0	1	1	1	1	1
5	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës		i mesëm	0	1	1	1	1	1
6	Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave		i mesëm	0	1	1	1	1	1
7	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike		i mesëm	0	1	1	1	1	1
8	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit		i mesëm	0	0	1	1	1	1
9	Biblioteka Shkencore		i mesëm	0	0	1	1	1	1
10	Rektorati		i mesëm	0	1	1	1	1	1
	SHUMA			3	8	10	10	10	10

Silvana Gushali, Audituese e Brendshme

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TIRANË
PLANI VJETOR I OBJEKTEVE PËR TË AUDITUAR NGA NJAB PER VITIN 2016

Pasqyra Nr.2

Nr	Objekte për t'u audituar nga NJAB	Niveli i vleresimit të riskut	Auditime Gjithsej	Llojet e auditimeve												Objekte te pa audituar mbi dy vjet	Grupi i auditimit (nr. i auditeve)	
				6-mujori I-re						6-mujori II-te								
				Te Plota	Financiare	Te perputhshmerise	Te performances	Ndjekja e zbatimit te rekomandimeve	Te tjera	Te Plota	Financiare	Te perputhshmerise	Te performances	Ndjekja e zbatimit te rekomandimeve	Te tjera			
	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	5.1	5.2	5.3	5.4	5.5	5.6	6	7	
1	Fakulteti i Tekn.së Informacionit	I mesëm	1											1			1	
2	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	I mesëm	1					1									1	
3	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	I mesëm	1					1									1	
4	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	I mesëm	1	1												1	1	
5	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	I mesëm	1	1												1	1	
6	Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave	I mesëm	1							1						1	1	
7	Fakulteti i Inxh. Matematike dhe Inxh. Fizike	I mesëm	1							1						1	1	
8	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit	I mesëm	0															
9	Biblioteka Shkencore	I mesëm	0															
10	Rrektorati	I mesëm	1							1							1	
	SHUMA		8	2	0	0	0	0	2	0	3	0	0	0	1	0	4	8

Silvana Gushali-Audituese e Brendshme

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TIRANË

Pasqyra Nr.4

PLANIFIKIMI VJETOR I KOSTOVE TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2016

Nr	BURIMET E PLANIFIKUARA			Nr	BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përlogaritja e burimeve		Treguesit e Kostos së Burimeve Burimeve Njerëzore të NJAB	Plani
	1	2	3		1	2
1	Koha maksimale e vlefshme	260	260	1	Buxheti Gjithsej	947,040
2	Pushime Vjetore	20	20	2	Paga dhe Sig.Shoqërore	899,040
3	Dite pushimi (Festa Zyrtare)	14	14	3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	0
4	Pushime për arsye shëndetësore	5	5	4	Të tjera	48,000
5	Angazhime në trajnime	7	7	5	Numri i Punonjësve	1
6	Angazhime në mbledhje/takime	4	4	6	Kosto për Person (1/5)	947,040
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	10	10			
	TOTALI	200	200 ditë/person			

Silvana Gushali, Audituese e Brendshme

**RISQET E IDENTIFIKUARA SIPAS SISTEMEMEVE
PËR VITIN 2016**

Nr	IDENTIFIKIMI I RISQEVE	VLËRSIMI I RISKUT		
		Mundësia e ndodhjes -- e lartë -- e mesme -- e ulët	Impakti -- i lartë -- i mesëm -- i ulët	Risku total -- i lartë -- i mesëm -- i ulët
1	2	3	4	5
1	<i>Risqet për Sistemet e Proçeseve Organizative</i>			
	<i>1.1 Risqet në Sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore</i>			
	<i>Rektorati</i>	E mesme	I mesëm	I mesëm
	<i>Fakultetet/IG.JEUM/Biblioteka Shkencore</i>	E mesme	I mesëm	I mesëm
	<i>1.2 Risqet në Sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit</i>			
	<i>Rektorati</i>	E mesme	I mesëm	I mesëm
	<i>Fakultetet/IG.JEUM/Biblioteka Shkencore</i>	E mesme	I ulët	I mesëm
2	<i>Risqet për Sistemet e Pagesave</i>			
	<i>Rektorati</i>	E mesme	I mesëm	I mesëm
	<i>Fakultetet/IG.JEUM/Biblioteka Shkencore</i>	E ulët	I mesëm	I mesëm
3	<i>Risqet për Sistemet e Prokurimeve/Investimeve</i>			
	<i>Rektorati</i>	E mesme	I mesëm	I mesëm
4	<i>Risqet për Sistemet e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar</i>			
	<i>Rektorati</i>	E mesme	I mesëm	I mesëm
	<i>Fakultetet/IG.JEUM/Biblioteka Shkencore</i>	E mesme	I mesëm	I lartë

5	<i>Risqet e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit</i>					
	<i>Risqe të tjera lidhur me sisteme specifike sipas misionit dhe qëllimit të institucionit</i>					
6	<i>Risqet për sistemet e krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytesore</i>					
	<i>Rektorati</i>				I mesëm	I mesëm
	<i>Fakultetet/IGJEU/M/Biblioteka Shkencore</i>				I mesëm	I mesëm

Silvana Gushali, Audituese e Brendshme



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Plani Strategjik dhe Vjetor i veprimtarisë së auditimit të brendshëm të Universitetit Politeknik Tiranë për periudhën 2025-2027

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) është institucion publik i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. UPT ka në përbërjen e tij 7 fakultete, një institut kërkimi e zhvillimi dhe një njësi ndihmëse.

Misioni i UPT është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë e të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor; të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar e rajonal; të mbështesë interesat strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit si dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.

Spektori i Auditimit të Brendshëm (AB) është pjesë e strukturës administrative të Universitetit Politeknik Tiranë, por është funksionalisht i pavarur dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë te Bordi i Administrimit.

I. Plani Strategjik për periudhën 2025-2027

- Qëllimi i planit strategjik dhe misioni i Spektorit të AB

Ky Plan Strategjik ka për qëllim të përcaktojë punën që do të ndërmerret nga struktura e auditimit të brendshëm të UPT për periudhën e ardhshme 3-vjeçare 2025-2027. Në këtë plan strategjik do të programohen veprimtaritë kryesore të planifikuara për t'u kryer në periudhën 2025-2027, për t'u siguruar që sistemet/fushat e identifikuar me risk mbulohen me auditim gjatë kësaj periudhe 3-vjeçare. Frekuenca e auditimit duhet të sigurojë përfshirje të mjaftueshme sipas kohës së përcaktuar në auditimin e subjekteve, për të dhënë një vlerësim të përgjithshëm të funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në UPT ka për qëllim të japë siguri objektive, të pavarur dhe të ofrojë shërbime këshillimi për Bordin e Administrimit, për të shtuar vlerë dhe përmirësuar veprimtarinë e UPT.

Misioni i AB është të përmirësojë dhe mbrojë vlerat e institucionit, duke ndihmuar në arritjen e objektivave, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

- Organizimi i Sektorit të AB dhe kuadri ligjor

Sipas paragrafit me nr.17 të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 27, datë 29.12.2017, strukturat e auditimit të brendshëm janë në varësi të Bordit të Administrimit.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në UPT është pjesë e strukturës administrative të Universitetit Politeknik Tiranë, dhe në strukturën organizative është miratuar me përbërjen 1+2, pra një përgjegjës sektori dhe dy specialistë.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në UPT, ushtron veprimtarinë mbi këtë bazë ligjore:

- Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; si dhe aktet nënligjore në zbatim të Ligjit Për Arsimin e Lartë në RSH.
- Ligjin Nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar; Manualin për Auditimin e Brendshëm, i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Kodin e Etikës për Audituesit e Brendshëm në sektorin publik, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.86, datë 10.12.2015 si dhe Kartën e Auditimit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm në UPT, miratuar me Vendimin e Bordit të Administrimit nr.10, datë 17.07.2018 (nr.1021 prot., datë 17.07.2018).

- Objektivat strategjike

Objektivat strategjike të Sektorit të Auditimit të Brendshëm janë:

- Përgatitja e planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, duke ruajtur frekuencën e auditimit dhe duke u bazuar në vlerësimin objektiv të riskut.
- Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontroleve në përmbushje të misionit të institucionit.
- Dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të UPT.
- Ndjekja në vazhdimësi e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.
- Identifikimi i subjekteve.

Referuar organizimit të UPT, subjektet e identifikuar për auditim janë:

- Struktura administrative dhe Struktura Akademike në nivel institucioni. Megjithatë, ky përcaktim nuk përjashton strukturat e tjera, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në funksion të të gjitha strukturave në institucion.
- Fakultetet- subjekte të identifikuar janë 7 (shtatë) dhe konkretisht: 1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës; 2. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike; 3. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike; 4. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit; 5. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit; 6. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave dhe 7. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike.
- Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit- subjekti i identifikuar është Instituti i Gjeoshkencave.
- Njësi ndihmëse- subjekt i identifikuar është Biblioteka Shkencore.

Subjekte të identifikuar si më sipër gjithsej janë 10 (dhjetë).

- Identifikimi i fushave /sistemeve prioritare

Nga auditimet e kryera në njësitë kryesore-fakultetet në varësi të UPT dhe nga mënyra e strukturimit dhe organizimit të menaxhimit financiar, janë identifikuar sistemet kryesore, në të cilat do të fokusohet veprimtaria audituese:

Sistemet e proceseve organizative: Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit;

Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore;

Sistemi i pagesave, në të cilin përfshihen edhe pagesat për projekte të ndryshme, si dhe shpenzimet për bursat e studentëve;

Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar;

Sistemi i prokurimeve/investimeve (gjatë auditimit të Strukturës Administrative të Rektoratit UPT, sepse procedurat e prokurimeve kryhen nga kjo strukturë, në nivel institucioni).

- Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve

Referuar kapitullit III të Manualit të Auditit të Brendshëm, gjatë përgatitjes së këtij plani janë rishikuar Format Standard Nr.1 dhe Format Standard Nr.2 i këtij kapitulli. Identifikimi dhe vlerësimi i përgjithshëm i riskut është bazuar jo vetëm në rishikimin e këtyre Format Standardeve, por i është referuar edhe gjetjeve nga auditimi i brendshëm i 7 (shtatë) njësive kryesore; gjetjeve nga auditimi i jashtëm (KLSH), si dhe funksionimit të UPT-së.

UPT është njësi shpenzuese e centralizuar; nëpunësi autorizues i cili ka depozituar firmën në thesar është Administratori i UPT, ndërsa nëpunësi zbatues i cili ka depozituar firmën në thesar është Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, pjesë e strukturës administrative në nivel institucioni.

Procedurat e punësimit të personelit të UPT administrohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike-strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucioni, sipas procedurave të miratuara; ndërsa procedurat e prokurimeve të UPT, janë të përqendruara, pra kryhen nga struktura administrative e UPT-së, edhe për llogari të njësive të vartësisë.

Vlerësimi i përgjithshëm për kontrollin e brendshëm për Struktura Administrative dhe Akademike në nivel institucioni është i Lartë, ndërsa për Fakultetet, Institutin dhe Bibliotekën Shkencore është përcaktuar në nivelin e Mesëm, sipas organizimit të UPT, argumentuar si më sipër.

- Kufizimet e Auditimit

Kufizimi kryesor i Sektorit të Auditit të Brendshëm është mosfunksionimi me strukturë të plotë, pra 1 përgjegjës dhe 2 specialistë.

Funksionimi me dy punonjës i njësisë së auditimit të brendshëm nuk mundëson rishikimin e brendshëm të cilësisë, proces i përcaktuar në Standardin 1300-Programi i Siguridhënies dhe Përmirësimit të Cilësisë dhe Standardit 1310-Kërkesat e Programit të Siguridhënies dhe Përmirësimit të Cilësisë.

Me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.40, datë 08.05.2017 “Për publikimin e Standardeve ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm në sektorin publik të pranuar për zbatim në Republikën e Shqipërisë”, dy standardet e përmendura më sipër janë pranuar për zbatim në vendin tonë.

Përveç sa më sipër, Sektori i AB në UPT, gjatë realizimit të programimit të bërë, mund të përballë me risqet e vetë auditimit, të cilat mund të jenë të brendshme dhe ose të jashtme, si përshembull: Rreziku i moszbulimit, i cili është rreziku që audituesi me përdorimin e procedurave thelbësore, nuk arrin të zbulojë një anomali.

Rreziku i mospërcaktimit të saktë dhe marrjes në konsideratë të nivelit të materialitetit.

- Prioritet për tre vite

Gjatë periudhës për të cilën po bëhet planifikimi 2025-2027, prioritet do të jetë kryerja e auditimeve sipas programimit, duke ruajtur frekuencën e auditimit si dhe duke konsideruar vlerësimin e nivelit të riskut.

Prioritet për këtë tre vjeçar, do të jetë edhe kryerja e auditimeve të performancës, si lloj auditimi i cili duhet të jetë në fokusin kryesor të veprimtarisë së auditit të brendshëm.

II. Plani Vjetor i auditimit 2025

- Zhvillimet aktuale të Sektorit të AB

Sikurse është përmendur më sipër, Sektori i Auditimit të Brendshëm në UPT, duke filluar nga muaji Nëntor 2019, funksionon vetëm me 2 (dy) punonjës, ndërkohë që struktura është miratuar me përbërjen 1+2.

- Prioritetet e auditimit për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, sektori i auditit të brendshëm do të ketë prioritet kryerjen sipas planifikimit të angazhimeve të auditimit, si dhe përmbushjen e plotë të këtij planifikimi, për të mos mbartur vitin pasardhës angazhime të parealizuara.

- Objektivi (at) kryesore për vitin 2025

Objektivat kryesore vjetore të sektorit të AB ne UPT janë:

- Programimi dhe kryerja e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke ruajtur frekuencën e auditimit dhe vlerësimin e riskut.
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e tij.
- Ndjekja në vazhdimësi të rekomandimeve të dhëna nga auditimet.

Programimi i llojit të angazhimeve

Referuar formatit standard të Pasqyrës Nr.3, programimi i angazhimeve është kryer vetëm për shërbimet e sigurisë dhe lloji i përzgjedhur i këtij shërbimi është auditim i përputhshmërisë. Sikurse jemi shprehur më sipër, pas plotësimit të strukturës së sektorit të auditimit të brendshëm, një prej sfidave me të cilat duhet të përballet ky sektor është edhe kryerja e auditimeve të performancës dhe auditimit të teknologjisë së informacionit; si prioritete kryesore për vitet në vazhdim.

- Planifikimi i kostos për vitin 2025

Kostoja e auditimit është përlllogaritur sipas zërave të përcaktuar në Pasqyrën Nr.5, në të cilën është përfshirë paga bruto si dhe shpenzime të tjera operative si kancelari e shtypshkrime, energji e ujë për dy punonjës. Kosto e planifikuar për vitin 2025 është kosto historike, i referohet përlllogaritjes së kostos së vitit të mëparshëm.

Në koston e auditimit nuk është parashikuar asnjë shpenzim për trajnim, meqenëse këto shpenzime parashikohen nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe meqenëse deri tani nuk është paracaktuar asnjë pjesëmarrje në trajnim jashtë vendbanimit ose dhe jashtë vendit.

- Planifikimi i burimeve për vitin 2025

Planifikimi i burimeve të auditimit për vitin 2025 është përgatitur mbi bazën e burimeve njerëzore aktuale në dispozicion, pra të dy punonjësve të sektorit. Për vitin 2025 janë përcaktuar për auditim 4 subjekte të identifikuara, të cilat do të synohen të realizohen.

- Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim

Identifikimi i temës së trajnimit “Hapat kryesore në kryerjen e Auditimit të Performancës-dhënie eksperience nga KLSH, nëpërmjet një rasti praktik”, është bërë meqë vitet në vazhdim fokusi kryesor i auditimeve duhet të jetë mbi auditimet e performancës.

Meqenëse Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ngritur departament të veçantë për auditimin e performancës, i cili kryen veprimtarinë e vet, ndër të tjera me Manualin e Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës, Udhëzues për Auditimin e Performancës dhe ka disa vite që kryen auditime të tilla, trajnimi praktik do të ishte shumë i dobishëm për strukturën tonë.

- Sigurimi i brendshëm i cilësisë


Struktura e sektorit të AB, nga muaji Nëntor 2019 e në vazhdim funksionon me dy punonjës, me këtë përbërje sërish është i pamundur të kryhet rishikimi i brendshëm të cilësisë.

Sikurse është përmendur vazhdimisht, vlerësimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë së auditit të brendshëm është përcaktuar në Standardin 1300 dhe Standardin 1310, si dhe në paragrafin me nr.II.8 të Kartës së Auditit të Brendshëm të Sektorit të AB në UPT, miratuar me Vendimin nr. 10, datë 17.07.2018 (nr.1021 prot.) të Bordit të Administrimit.

Ju faleminderit për bashkëpunimin,

Përgjegjëse e Sektorit të Auditimit të Brendshëm

Brikena Pojani



SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TIRANË

Pasqyra 1

Vlerësimi i nivelit të riskut për të gjithë subjektet që duhet të auditohen nga NJAB

Nr	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT		
			I lartë	I mesëm	I ulët
a.	1	2	3	4	5
1	Struktura Administrative dhe Struktura Akademike në nivel Institucioni	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2.Sistemi i prokurimeve të mallrave, shërbimeve dhe investimeve 3.Sistemi i pagesave 4.Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 5.Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhimin e aktiveve, Drejtoria Ekonomike (Sektori i financës dhe Sektori i buxhetit) 1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2.Sistemi i pagesave 3.Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 4.Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar			
2	Instituti i Gjeoshkencave	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2.Sistemi i pagesave 3.Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 4.Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar			
3	Biblioteka Shkencore	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2.Sistemi i pagesave 3.Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 4.Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar			
4	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2.Sistemi i pagesave 3.Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 4.Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar			

			VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT		
Nr	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	I lartë	I mesëm	I ulët
			3	4	5
a.	1	2			
5	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2.Sistemi i pagesave 3.Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 4.Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar			
6	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2.Sistemi i pagesave 3.Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 4.Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar			
7	Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minerave	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2.Sistemi i pagesave 3.Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 4.Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar			
8	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2.Sistemi i pagesave 3.Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 4.Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar			
9	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2.Sistemi i pagesave 3.Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 4.Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar			

Nr	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT		
			I lartë	I mesëm	I ulët
a.	1	2	3	4	5
10	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	1. Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2. Sistemi i pagesave 3. Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 4. Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar			

Brikena Pojani, Përgjegjëse e Sektorit të A.B.



Plani strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2025-2027

SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE							
Nr	Viti planifikuar	Niveli i Riskut (V. planifikuar)	Viti I planif+1	Niveli i Riskut (V. planif.+1)	Viti I planif+2	Niveli i Riskut (V. planif.+2)	
	2025		2026		2027		
a.	1	2	3	4	5	6	
1	Auditimi mbi rekomandimet e lëna gjatë auditimeve 2024	I Mesëm					
2	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	I Mesëm					
3	Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave	I Mesëm					
4	Struktura Administrative dhe Struktura Akademike në nivel Institucional	I Lartë					
5	Biblioteka Shkencore	I Mesëm					
6			Instituti i Gjeoshkencave	I Mesëm			
7			Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	I Mesëm			
8			Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	I Mesëm			
9			Fakulteti i Inxhinierisë së Nderimit	I Mesëm			
10					Struktura Administrative dhe Struktura Akademike në nivel Institucional		I Lartë
11					Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës		I Mesëm
12					Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike		I Mesëm
13					Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit		I Mesëm
14					Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave		I Mesëm
	SHUMA						

Përgjegjëse e Sektorit të A.B.

Brikena Pojani



Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2025

Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditime Gjithsej	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet e konsulentëve	Grupi i Auditimit (nr.auditues)
				A. të përputhshmërisë	A. të performancës	Financiare	A.tek.Informacionit	A. të kombinuara		
a.	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	5
1	Auditimi mbi rekomandimet e lëna gjatë auditimeve 2024	Rekomandimet e auditimit sipas subjekteve	1							2
	2 Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit. 2. Sistemi i pagesave 3. Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore. 4. Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar	1	1						2
	3 Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minerave	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit. 2. Sistemi i pagesave 3. Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore. 4. Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar	1	1						2

Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditime Gjithsej	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet e konsulentëve	Grupi i Auditimit (nr.auditues)
				A. të përputhshmërisë	A. të performancës	Financiare	A.tek.Informacionit	A. të kombinuara		
a.	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	5
			$(4.1+4.2+4.3+4.4+4.5+4.6)$							
4	Struktura Administrative dhe Struktura Akademike në nivel Institucioni	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njëzore. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2. Sistemi i prokurimeve të mallrave, shërbimeve dhe investimeve 3. Sistemi i pagesave 4. Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 5. Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhimin e aktiveve, Drejtoria Ekonomike (Sektori i financës dhe Sektori i buxhetit)	1	1						2
5	Biblioteka Shkencore	1.Sistemet e proceseve organizative Sistemi i menaxhimit të burimeve njëzore. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit 2. Sistemi i pagesave 3. Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore 4. Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar	1	1						2
	SHUMA		4	4	0	0	0	0	0	8

Përgjegjëse e Sektorit të A.B.

Brkena Pojani



Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2025

BURIMET E PLANIFIKUARA				BUXHETI I PLANIFIKUAR			
Nr Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NJAB		Ditë për tregues	Përllogaritja e burimeve	Nr Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB		Plani	
1	2	3		1	2		
1 Koha maksimale e vlefshme	520	520		1 Buxheti Gjithsej		332,842	
2 Pushime Vjetore	40	40		2 Paga dhe Sig.Shoqëtorë		232,840	
3 Dite pushimi (Festa Zyrtare)	28	28		3 Shpenzime Udhëtimi & Dieta		0	
4 Pushime për arsye shëndetësore	10	10		4 Të tjera		100,000	
5 Angazhime në trajnime	14	14		5 Numri i Punonjësve		2	
6 Angazhime në mbledhje/takime	20	20		6 Kosto për Person (1/2)		166,421	
7 Rezerva të Planifikuara (të papritura)	20	20					
TOTALI	388	388 ditë për dy persona					

Përgjegjëse e Sektorit të A.B.

Brikena Pojani

